

1



2



3



INFORMATIKA 4

Autore: Besa MATI

Përgatiti për botim:
Dr. Doriana BROKAJ

Redaktorë shkencorë:
Dolores CIPO
Lirak HAMITI

Redaktore letrare:
Oriana Osmani


Ilustrues:
Heldi PEMA

Kopertina:
Heldi PEMA dhe Besa MATI



2018 © Të gjitha të drejtat e botimit i ka SHBLSH e RE
ISBN: 978-99943-2-416-3

SHBLSH e RE - Rr. Mine Peza, P.1/1, Tiranë
www.shblsh.com / info@shblsh.com / +355 4 2222 3633
Shitje online: www.botimeshqip.com, www.besamati.com



Përmbajtja

INFORMATIKA 4

LINJA 1 Bota e kompjuterit 4

1	Komunikimi dhe kodi	6
2	Makinat e para llogaritëse dhe kompjuteri	10
	<i>Lexim: Para shumë vitesh dhe sot</i>	11
3	Kompjuteri personal	14
4	Memoria jonë dhe memoria e kompjuterit	18
	<i>Lexim Çfarë është disketa apo "Floppy Disk"?</i>	20
5	Sistemi Operativ Windows dhe programet	22
6	Hardware-Software dhe ikonat	26
7	Ushtrime për përsëritje	30
8	Veprimtari 1	36
	Test	37

LINJA 2 Përpunimi digjital i të dhënave 38

1	Programi WordPad dhe tastiera e kompjuterit	40
2	Madhësia dhe lloji i shkrimit. Shkronjat ë dhe ç	42
3	Zbukurimi i tekstit	44
4	Zgjedhja e tekstit dhe disa komanda të rëndësishme	46
5	Ushtrime	48
6	Orientimi dhe ngjyra e tekstit	50
7	Fotografia dhe printimi i punës	52
8	Ushtrime për përsëritje	54
9	Veprimtari 2	56
	Test	57

LINJA 3 Kreativiteti dhe programimi 58

1	Programi Paint.	
	Mjeti i lapsit dhe penelit	60
2	Dosja e vizatimit dhe mjeti i kovës	62
3	Mjeti i gomës, numrat dhe shkronjat	64
4	Vija dhe forma.	
	Komandat "zgjedh, kopjoj, vendos"	66
5	Teksti dhe fotografia	68
6	Ushtrime për përsëritje	70
7	Veprimtari 3	72
	Test	73

LINJA 4 Kërkimi në web/internet 74

1	Rrjeti dhe rruga e informacionit	76
2	Interneti dhe gjuha e kompjuterëve	78
3	Programi Internet Explorer	80
4	Faqet e internetit dhe kërkimi i informacionit	82
5	Interneti për fëmijë.	
	Kërkimi inteligjent	84
6	Ushtrime për përsëritje	86
7	Veprimtari 4	88
	Test	89

LINJA 5 Siguria në internet dhe siguria e të punuarit në kompjuter 90

1	Verifikimi i informacionit	92
2	E meta e internetit.	
	Të dhënat personale	94
3	Ushtrime për përsëritje	96
4	Veprimtari 5	98
	Test	99

FJALOR 100



Eh.. Duhet kohë për ta rregulluar, sepse është goditur shumë fort...

Mos u mërzit! Inxhinieri do ta rregullojë!

Sa më shpejt! Më duhet për të komunikuar me familjen time. Ata jetojnë jashtë Shqipërisë!

Kur ju nevojitet zonjë?

LINJA 1

Bota e kompjuterit



1

Komunikimi dhe kodi

Njerëzit kanë pasur gjithmonë nevojë për të komunikuar me njëri-tjetrin, për të dërguar mesazhe apo lajme. Komunikimi është veprim thelbësor në jetë. Ai mund të kryhet me gojë, me shkrim ose me kod. Edhe mjetet për të komunikuar janë të ndryshme. Ka mjete që komunikojnë edhe me shumë, shumë njerëz në të njëjtën kohë. Mjetet më të lashta që njeriu ka përdorur për të komunikuar janë shprehjet e fytyrës dhe gjestet e trupit. Edhe drita është mjet komunikimi.



1 Për secilën nga figurat, shkruaj llojin e komunikimit.

• komunikim me gojë • komunikim me shkrim • komunikim me kod

Para shumë vitesh

A



komunikim me _____

B



komunikim me _____

C



komunikim me _____

Sot

A




komunikim me _____

B



komunikim me _____


C



komunikim me _____

- 2** Shkruaj emrat e secilit prej mjeteve të komunikimit që tregohen në figura.
Rretho mjetet përmes së cilave komunikohet me shumë njerëz në të njëjtën kohë.

Për fjalët anglisht do të të ndihmojë fjalori në fund të librit!



R _____



K _____



L _____



L _____



T _____




S _____



T _____





T _____



R _____ M _____

- 3 a** Diskuto në klasë se çfarë të komunikon drita e llambës së ndezur të semaforëve.

- b** Diskuto në klasë se çfarë të komunikon drita e llambës së ndezur të sinjaleve të makinës.



- 4 Shiko me vëmendje vizatimet dhe shkruaj çfarë komunikojnë fytyrat më poshtë.
- frikë • gëzim • dhimbje • mospëlqim



- 5 Diskuto më shokët dhe shoqet dhe shkruaj mesazhin që të komunikon çdo simbol.

















Për të komunikuar duhet një kod. Shkronjat e alfabetit janë një kod. Po ashtu edhe drita e semaforit dhe sinjalet e makinave. A di ndonjë kod tjetër?

6 1 Shëno me X përgjigjen e saktë.

- Jo të gjitha shkronjat e alfabetit formojnë një kod. ☐
- Notat muzikore formojnë një kod. ☐



7 a Ku mund ta gjesh kodin special që tregohet më poshtë?

- Mbi telefon, sepse regjistron numrat më të veçantë. ☐
- Në hyrjen e shkollës. ☐
- Në paketimet e të gjitha produkteve që shiten, ku shërben për të identifikuar produktin, çmimin etj. ☐

b Si quhet kodi special?

- Bar Kod ☐
- Vija-Vija ☐
- Komunikues të dhënash ☐



8 Pajisja që tregohet në figurë, po të lidhet me linjën telefonike, dërgon dokumente nga njëra zyrë në tjetrën, edhe sikur zyrat të jenë në shtete të ndryshme.

Si e ka emrin?

- Komunikues shtypi ☐
- Makinë shkrimi ☐
- Faks ☐



9 Nëse nget biçikletën dhe duhet të kthehesh majtas, si ja komunikon njerëzve dhe makinave këtë veprim?

- Shtrin krahun e majtë horizontalisht ☐
- Ndalon biçikletën ☐
- Fishkëllen fort ☐



2 Rretho ose shkruaj versionin Windows që përdor.

- **Windows 10**
- **Windows 8**
- **Windows Vista**
- _____

3 Zbato këto veprime për të gjetur listën e programeve që ofron Windowsi.



- 1 • Ndiz ekranin**
- 2 • Ndiz kompjuterin**
- 3 • Prit**
- 4 • Shtyp butonin START**
- 5 • Shtyp "All Programs"**

Që kompjuteri të na ndihmojë të kryejmë një punë të caktuar, duhet t'i regjistrojmë në memorie një program që di ta kryejë atë punë. Me programe të veçanta ne mund të:

- të shkruajmë
- të llogarisim
- të vizatojmë
- të kompozojmë muzikë
- të luajmë
- të dërgojmë mesazhe
- ... e shumë, e shumë, punë të tjera.

4 Shkruaj në fletore një listë të programeve që gjete. Si mendon, për çfarë shërbejnë ato?

WordPad-i dhe Paint-i janë programe shumë të njohura për të shkruar dhe vizatuar. Edhe ata e kanë pamjen me dritare, që hapen, mbyllen, zmadhohen dhe zvogëlohen.



Sistemet operative dhe programet ndryshojnë nga njëri-tjetri.

Imagjino një hidrocentral (në rastin tonë sistemi operativ) dhe një llambë elektrike (në rastin tonë programi).

Hidrocentrali, që prodhon energji elektrike, nuk është i dobishëm nëse energjia e tij nuk përdoret. Falë llambës elektrike që kryen një punë të caktuar, ndriçimin, ti kupton dobishmërinë e hidrocentralit.



• CD-ja me programin e sistemit operativ Windows 10.


• CD-ja me programin Norton. Ky program mbron kompjuterin nga viruset (programe që e dëmtojnë kompjuterin).

5 Gjej shembuj të tjerë për të treguar ndryshimin midis sistemit operativ dhe programit.

Programet pa sistemin operativ nuk punojnë.

Sistemi operativ pa programet, nuk është i dobishëm për punët që kemi.

6 Puno dhe ti si kompjuteri. Procesori i njeh dhe i zbaton komandat sipas radhës. Zbato edhe ti komandat sipas radhës.




Por çfarë janë dosjet dhe skedarët? Dosjet dhe skedarët ndryshojnë njëri nga tjetri. Imagjino një dollap të madh (në rastin tonë dosja). Kur hap dyert, ti sheh rroba të varura dhe të palosura (në rastin tonë skedarët). Nga ky shembull ti kupton se skedarët grumbullohen brenda në dosje ose nën-dosje.



DOSJE / 1 copë
NËN-DOSJE / 4 copë
SKEDARË / 15 copë


1 Renditi ikonat sipas rendit alfabetik.
 Çfarë ndryshimi vëren tek emrat e tyre?




1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12


2 Vendos në diagramë veprimet dhe pyetjet që duhen bërë për të përgatitur supë me perime dhe oriz.

- Shtova orizin në tenxhere • Vura tenxheren mbi sobë • Prita
- Hodha supën në pjata • Hodha ujin në tenxhere
- Shtova perimet dhe kripën në tenxhere • A është bërë supa?



3 Puno dhe ti si procesori. Lexo me kujdes komandat dhe shkruaj rezultatet në kutitë djathtas, ashtu siç tregohet te shembulli.





Një "hard disk" i veçantë, me "dosje" dhe "skedarë"

1 Gjej një kuti të vogël dhe zbukuroje me disketa. Kërko ndihmën e të njohurve për t'i gjetur, pasi nuk prodhohen më. Mund t'i gjesh edhe në dyqanet që rregullojnë kompjuterët. Nëse nuk i gjen dot, zbukuroje kutinë me vizatimet e tyre ose me CD-ROM-e.





2 Bëj 2 vizatime që të kenë në kompozim edhe një laptop ose kompjuter personal dhe ruaji vizatimet në kutinë që krijove.

3 Shkruaj me dorë një hartim të shkurtër për evolucionin e pajisjeve elektronike në shtëpinë tënde dhe vendose në kuti.

4 Në këtë kuti ti do të ruash si kujtime të gjitha punët që do të bësh këtë vit në lëndën e informatikës. Kutia do të shërbejë si "hard disk-u" yt dhe punët e tua si "dosje" dhe "skedarë".

5 Në fund të vitit do të bëni një ekspozitë me krijimet dhe kujtimet e gjithë shokëve të klasës.

6 Krijimet më të mira mund t'i vendosni në muzeun e shkollës, në kabinetin e shkencës ose vizatimit.



- 2 Shkruaj me shkrim dore emrin për çdo vizatim. Pastaj kopjo në kompjuter të gjithë emrat që ke shkruar, duke përdorur vetëm shkronja të vogla.



1	6
2	7
3	8
4	9
5	10

- 3 Çfarë ke sot në çantë? Vizatoji disa prej këtyre gjërave dhe pastaj shkruaj emrin e tyre me kompjuter, duke përdorur vetëm shkronja të vogla. Përdor shkrimin "Arial" dhe madhësinë "13".

1

2

3

- 4 Shkruaj në kompjuter me shkronja të vogla dhe të mëdha fjalët më poshtë. Vendos llojin e shkrimit dhe madhësinë që do të përdorësh. Më pas, kërko ndihmën e mësuesit/es për të mbyllur WordPad-in.

• ëmbëlsirë • çati • ëndërr • çekiç • emër • çfarë • është
 • çon • shkollë • çudi • klasë • çelës

- 3** Zbato sipas radhës veprimet për zbulimin e tekstit dhe regjistrimin e skedarit "andi - 4 nëntor.DOC".
Më pas, zgjidhe gjithë tekstin dhe bëje me shkrimin Helvetica, 12, me stilin e theksuar.

1 Kliko një herë në fillim të tekstit dhe rrëshqite mausin deri në fund të tij

2 Zgjidh llojin e shkrimit "Times New Roman"

3 Zgjidh madhësinë 10

4 Kliko tek ikona e stilit të pjerrët

4 Kliko mbi "File"

5 Kliko mbi "Save"

- 4** Zbato sipas radhës veprimet për të ruajtur të njëjtin skedar edhe me një emër tjetër.


1 Kliko mbi "FILE"

2 Zgjidh "SAVE AS"

3 Shkruaj një emër tjetër të pjesa e emrit, p.sh, "andi - 11 nëntor"

4 Shtyp OK

Ja çfarë ka tani brenda dosja "andi WordP":



"andi WordP" ↑

- 5** Zbato sipas radhës veprimet për të mbyllur skedarin dhe programin WordPad.

1 Kliko mbi "FILE"

2 Zgjidh "Close"

3 Kliko mbi "FILE"

4 Zgjidh "Exit"

8

USHTRIME

- 1 Lexo fjalët. Lidh në dyshe emrat e kafshëve dhe ushqimeve. Shkruaji dyshtet me kompjuter.

Bëji me stilin e nënvizuar dhe:

- me të kuqe emrat e kafshëve
- me të gjelbër emrat e ushqimeve

Shembull: panterë dardhë

- | | | | |
|---------|-----------|-----------|----------------|
| • mollë | • kalë | • dardhë | • luleshtrydhe |
| • ujk | • rrugë | • luan | • shtëpi |
| • lopë | • bukë | • këpucë | • tren |
| • dele | • libër | • sallatë | • mish |
| • pemë | • djathë | • karrige | • pikturë |
| • çantë | • panterë | • banane | • kompjuter |

- 2 Shkruaj me kompjuter katër fjali me disa nga emrat që nuk bënë pjesë në dyshtet që formove.

- 3 Shkruaj me kompjuter tekstin dhe rregulloje sipas udhëzimeve:

- I gjithë teksti duhet të jetë me llojin e shkrimit Helvetica, me përmasë 12
- Gjej një titull të përshtatshëm, bëje të theksuar, me madhësi 14 dhe ngjyrose
- Pas titullit lër një rresht bosh
- Disa fjalë të rëndësishme duhet të jenë me stil të theksuar
- I gjithë teksti duhet të jetë i orientuar djathtas

"Ky këtu është PERPETUMOBILI, të cilin e zbuluan dhe e ndërtuan dy makinistët e famshëm, Lukasi dhe Xhim Kopsa. Ai jo vetëm që lëviz, d,m.th ecën, fluturon, noton dhe zhytet në ujë në sajë të energjisë që prodhon vetë, por po të duash edhe mund ta fikësh. Në vizatimin A është paraqitur Perpetumobili i plotë në punë dhe pikërisht duke ecur përpara. Ndërsa në vizatimin B janë paraqitur pjesë të veçanta të Perpetumobilit në gjendje të fikur. Po i njëjti mekanizëm është paraqitur në vizatimin C, vetëm se tani është i ndezur. Shpresojmë se ju a kemi paraqitur fort qartë Perpetumobilin lexuesve."

"Xhim Kopsa dhe 13 të tërbuarit", Mihael Ende

- 4 Si mund të ishin vizatimet A, B dhe C të tekstit më sipër? Bëj tre skica të thjeshta. Me ndihmën e mësuesit/es, mundohu t'i vendosësh ato në tekst. Regjistroje punimin në dosjen e shkrimit dhe më pas printoje.

Një tastierë “speciale” dhe një shkrim kërkimor

1 Vizato një tastierë kompjuteri me gjerësi 29 cm dhe lartësi 10 cm. Bëj me ngjyra të ndryshme pjesën e butonave speciale, pjesën e shkronjave, numrave etj.

2 Shkruaj me shkrim dore një hartim për evolucionin e mënyrës së të shkruarit në familjen tënde. Kërko të dish nga gjyshërit, prindërit dhe të afërmit se me çfarë shkruanin dhe ku i mbanin shënimet më parë, ku i ruanin dhe si mundoheshin të ishin të rregullt.

3 A i emërtonin ata dosjet? Po datën dhe vitin a ju a shkruanin?

4 Shkruaje hartimin edhe me kompjuter.

5 Printoje.


6 Vendose vizatimin e tastierës dhe 2 hartimet në hard disk-un “special” që krijove me disketa dhe disqe në veprimtarinë e Linjës 1.

7 Sa “skedarë” të janë mbledhur deri tani në “hard disk-un” tënd?




Nga WordPad-i te Paint-i


- 3 Minimizo dritaren e programit Paint. Hap nga dosja e shkrimit skedarin "Vendbanimi im". Shko përsëri te programi Paint dhe përdor komandat: **"zgjedh, kopjoj"** për qytetin që vizatove. Shko te skedari "Vendbanimi im" dhe zbato komandën **"vendos"** në fund të fjalive. Regjistroje skedarin.



- 4 Plotëso në fletore vazhdimin e skemës së printimit për programin Paint. Ajo është e njëjtë si për programin WordPad.




- 6 Vendos rrjetën në fletën e vizatimit. Shtyp ikonën e lentes zmadhuese **1**. Përdor **SHIFT-in** për të bërë një katror. Përdor 3 komandat: **“zgjedh, kopjoj, vendos”** për të formuar me katrorin dy numra dhe dy shkronja.




- 7 Vizato shtëpinë. Zbato komandat.


Vizato




Dyfisho



Pasqyro



Plotëso



- 8 Më poshtë tregohen pikturat e dy artistëve të njohur, Joan Miro dhe Haldi Pema. Ata kanë përdorur shumë forma gjeometrike. Bëj edhe ti një pikturë me mjetet e Paint-it. Përdor figura gjeometrike, vendosi pikturës titull dhe printoje.



Joan Miro



Haldi Pema



Joan Miro



Haldi Pema

5

Interneti për fëmijë. Kërkimi inteligjent

- 1 Zbato veprimet djathtas në Internet Explorer (I.E).
Çfarë lloj faqesh hapen?

Pas veprimeve:

Po të klikosh mbi 1 hapet faqja "Kiddle";
Po të klikosh mbi 2, hapet faqja "Kidrex".

1 Hap programin I.E

2 Shtyp "CTRL+N"

3 Shkruaj adresën
www.kiddle.co

4 Shtyp "CTRL+N"

5 Shkruaj adresën
www.kidrex.org



Programuesit e shërbimeve të internetit kanë menduar që edhe fëmijët të kenë faqet e tyre në internet. Këto faqe janë më të bukura dhe më të sigurta për moshën tënde. Dy faqet "Kiddle" dhe "Kidrex" janë motorë kërkimi për fëmijë.

Nëse kërkon vetëm fotografi, në fillim duhet të shtypësh "Images", nëse kërkon vetëm filmime shtyp "Videos", e nëse kërkon çdo lloj informacioni shtyp "web".



- 2 Bëj një kërkim për foto në "Kiddle", p.sh. "computer". Pastaj kërko "computer personal".

TEST

Zgjidh përgjigjen e saktë.

A - Për çfarë shërben

Internet Explorer?

- 1** për të hapur kompjuterin;
- 2** për të vizatuar;
- 3** për të lundruar në internet.

B - Për çfarë shërben rrjeti i metrosë?

- 1** për të matur gjatësinë e rrugëve;
- 2** për të shkuar shpejt nga njëri vend në tjetrin;
- 3** për të kontrolluar orarin e avionëve.

C - Cila pjesë e Internet Explorer nuk ngjan me Paintin?

- 1** shiriti i menuve;
- 2** faqja kryesore;
- 3** pjesa e komandave.

Ç - Me çfarë fillon adresa e internetit?

- 1** me Ctrl;
- 2** me Ppp;
- 3** me www.

D - Ku ngjan skedari me adresën e faqeve?

- 1** te emri;
- 2** te prapashtesa;
- 3** te numri i shkronjave.

Dh - Çfarë është interneti?

- 1** rrjeti botëror i Informacionit;
- 2** bashkësia e pjesëve të kompjuterit;
- 3** bashkësia e programeve.

E - Cila formë nuk është rrjet?

- 1** yll;
- 2** makinë;
- 3** unazë.

Ë - Çfarë shfleton Internet Explorer?

- 1** libra;
- 2** faqe interneti;
- 3** fletore matematike.

F - Motorët e kërkimit:

- 1** janë njerëz që punojnë në bibliotekë;
- 2** janë programe kompjuterike;
- 3** janë kompjutera shumë të shtrenjtë.

G - Ku u shpik interneti?

- 1** në SH.B.A;
- 2** në Kinë;
- 3** në Rusi.

Gj - Prej kujt u shpik interneti?

- 1** prej një eksperimenti të papritur;
- 2** prej një garë teknologjike;
- 3** prej një ushtrimi matematik.

H - Nëpërmjet kujt lidheshin më parë njerëzit në internet?

- 1** nëpërmjet radios;
- 2** nëpërmjet televizorit;
- 3** nëpërmjet telefonit.

I - Nga buron informacioni në internet?

- 1** nga njerëz;
- 2** nga objekte;
- 3** makina elektronike.

J - Cilën rrugë ndjek informacioni në internet?

- 1** më të gjatën;
- 2** më të vështirën;
- 3** më të shkurtrën.

1

Verifikimi i informacionit

Në botën e internetit, ku miliona njerëz kanë të drejtë të publikojnë çdo gjë që u shkon ndër mend, nëse nuk ke kujdes, e merr gënjeshtren për të vërtetë. Prandaj, duhet të mësosh ta verifikosh informacionin dhe të bazohesh vetëm tek ai i vërteti. Ti duhet të mësosh të “filtrosh” informacionin që merr nga shfletuesit e faqeve.



- 1** Diskuto në klasë për këto 3 situata:
- A** Ti lexon në internet se një kometë do të përplasht me Tokën. Ky lajm është i shoqëruar edhe me fotografinë e kometës, ku duket qartë se ajo është afër me Tokën.
- Si vepron ti në këtë rast? • A do të ishe frikësuar? • A do t'i tregojë prindërve të të ndihmonin për të kuptuar më shumë mbi kometat dhe planetet?
 - Si do ta verifikojë këtë informacion?
- B** Motra jote e vogël të tregon një fotografi shumë të bukur të një pinguini në plazhin e Durrësit.
- Si do t'ia shpjegojë motrës tënde se ky informacion është i rremë? • Në cilën hemisferë jetojnë pinguinët?
 - Ku e ke mësuar këtë?



B Pasi shkarkove një lojë nga interneti, pas disa ditësh kompjuteri yt fillon të sillet në mënyrë të çuditshme. Ai fiket vetë herë pas here.

- Si mendon: çfarë i ka ndodhur kompjuterit?



Çfarë janë të dhënat personale?

Të dhënat personale janë ato që të identifikojnë ty si individ. Ato të bëjnë të dallueshëm nga individët e tjerë.

Çfarë dmth të mbrosh të dhënat personale?

Të mbrosh të dhënat personale do të thotë mos t'ia tregosh ato të panjohurve, apo dikujt tjetër. Mbrojta më e mirë është zgjuarësia jote. Ti duhet të mbrosh edhe të dhënat personale të familjes tënde, sidomos nga të panjohurit.

Nuk është mirë të shohësh ekranin e kompjuterit, apo telefonit, tabletës, laptopit të të tjerëve, dhe të bëhesh kurioz për veprimet e tyre. Ato janë të dhënat dhe punët e tyre personale, që ty të ndalohej t'i shohësh.

4 Shkruaj shkurt në fletore vazhdimin e tregimit më poshtë, duke përdorur fjalët:

- **antivirus** • **shkarkim** • **virus** • **rrezik** • **dhuratë** • **falas**

Jonit pa një skedar në një faqe interneti. Ai gëzohet shumë, sepse skedari ka emrin e lojës së tij të preferuar. Joni do që ta shkarkojë menjëherë skedarin, që të luajë sa më shpejt lojën. Në këtë çast, afrohet vëllai i madh i tij, Drini, i cili shpjegon se...

5 Shkruaj shkurt në fletore vazhdimin e tregimit më poshtë, duke përdorur fjalët:

- **faqe interneti e pakontrolluar** • **reklamë** • **mami i shpjegoi se** • **rrezik** • **dhuratë** • **nuk i lejohej** • **“u bombardua”** • **pa leje** • **e dhënë personale**

Lira hyri në një faqe interneti për lodra. Ajo regjistroi adresën elektronike të mamit, që mami i Lirës të njoftohej për lodrat e reja që do të dalin. Gjatë javës në vijim, adresa elektronike e mamit të Lirës...

FJALOR

Si përdoret fjalori?

gridline (gridllajn) rrjetë.

1

2

3

1. fjala anglisht

2. si lexohet

3. përkthimi në shqip

A

- **accessories (eksësoris)** "aksesor", diçka shtesë, që i shtohet një elementi tjetër për ta bërë më të dobishëm.
- **all programs (all progrëms)** gjithë programet.
- **alt - alternative (allt, alltërnativ)** alternativë.

B

- **bold (bolld)** i/e theksuar.
- **browser (brouzër)** shfletues.

C

- **canc - cancel (kens, kensëll)** anulohet.
- **caps (kaps)** shkronjë e madhe shtypi.
- **caps lock (kaps llok)** çelësi për të shkruajtur vetëm me shkronja të mëdha.
- **cd - compact disk (sidi, komplet disk)** kompakt disk (memorie).
- **chat (çet)** bisedë.
- **close (klous)** mbyll.
- **computer (kompjutër)** kompjuter.
- **ctrl - control (ci.ti.er.el, kontroll)** kontroll.

D

- **delete (dillit)** fshi.
- **desk (desk)** tavolinë pune.
- **desktop (desktop)** "desktop", pamja në ekran që paraqitet kur hapet kompjuteri, ku ka ikona të ndryshme.
- **desktop computer (desktop kompjutër)** kompjuter që rri mbi tryezë, ndryshe nga laptopi që merret edhe me vete.
- **disk (disk)** disk.
- **document (dokumënt)** dokument.

E

- **eclipse (ekllips)** eklips.
- **end (end)** fund.
- **enter (entër)** fut, ekzekuto.
- **exit (eksit)** dil.
- **explorer (ekspllorër)** eksplorues, zbulues.

F

- **floppy disk (flop disk)** disketë.
- **file** skedar.
- **friendly (frendlli)** miqësor/e.

G

- **gridline (gridllajn)** rrjetë.

H

- **hard (hard)** i/e fortë.
- **hard disk (hard disk)** kujtesë (memorie) e kompjuterit.
- **hardware (harduer)** pjesë fizike e kompjuterit.
- **home (houm)** shtëpi.
- **insert (insërt)** fut.

I

- **Internet (Intërnet)** internet.
- **Internet Explorer (Intërnet - Iksplorër)** program i Windows.

J

- **James Clerk Maxwell (Xhejms Kllërk Meksuëll)** shkencëtar.

K

- **kid (kid)** fëmijë.

L

- **laptop (leptop)** kompjuter që mund ta mbash në prehër, që punon edhe me bateri dhe mund ta marrësh me vete.
- **link (link)** hallkë, zinxhir.
- **lock (llok)** çelës.

M

- **mouse (maus)** mi.
- **motherboard (madhërbord)** skeda mëmë, qark elektrik ku lidhen pjesët e kompjuterit, si procesori, kujtesat dhe qarqe të tjerë.
- **moon (mun)** hënë.
- **more (mor)** më shumë.

N

- **NASA (neza)** NASA, administrata amerikane e aeronautikës dhe hapësirës.
- **narrow (nerrou)** i/e pjerrët.
- **National Geographic (nejshënell xheogrefik)** revistë shkencore.
- **network (netuërk)** rrjet.
- **new file (nju fajll)** skedar i ri.
- **new folder (nju foldër)** dosje e re.

O

- **open (oupen)** hap.
- **operating system (opërejtin sistem)** sistemi operativ.

P

- **phone (foun)** telefon.
- **personal computer (personëll kompjutë)** kompjuter personal, i projektuar që mos ta përdorin disa njerëz në të njëjtën kohë.
- **processor (prosesër)** procesor.
- **pad (ped)** bllok shënimesh
- **Paint (peint)** vizatoj.
- **print (print)** printo.
- **preview (privju)** shikim paraprak.
- **pictures (pikçërs)** fotografi.

R

- **ruler (rullër)** vizore.

S

- **save (sejv)** ruaj.
- **sateliti** objekt në hapësirë.
- **shift (shift)** ndrysho.
- **smart** i/e zgjuar.
- **smart phone (smart fon)** telefon "i zgjuar", celular, që përmban edhe aplikacione.
- **soft (soft)** i/e butë.
- **software (softuer)** programet e kompjuterit.
- **space (spejs)** hapësirë.
- **start (start)** fillo.

T

- **tablet computer (tablet kompjutër)** kompjuter tabletë (si pllakë e sheshtë) që punon me aplikacione.

- **taskbar (teskbar)** pjesa në "desktop" ku rrinë programet që përdoren më shpesh, dosjet që janë hapur, antivirusi, ora etj.

- **top (top)** mbi.

- **translate (transllejt)** përkthe.

- **turn off (tërn of)** fik.

U

- **USB (juesbi)** hard disk i vogël.

- **underline (andellajn)** i/e nënvizuar.

V

- **virtual (virçuëll)** diçka që nuk ekziston fizikisht.

- **videos (videos)** filmime.

- **virus (virës)** virus.

W

- **www - world wide web (dabëllju dabëllju dabëllju, uorlld uajd ueb)** rrjeti i gjerë botëror.

- **web (ueb)** rrjetë (si e merimangës).

- **website (uebsajt)** faqe interneti.

- **wide (uajd)** i/e gjerë.

- **window (uindou)** dritare.

- **Windows (Windous)** markë sistemi operativ.

- **word (uord)** fjalë.

- **WordPad (Wordped)** program shkrimi në Windows.

- **world (uorlld)** botë.

- **wikipedia (uikipidia)** faqe interneti, si enciklopedi ku njerëzit grumbullojnë informacionin që dinë.